REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery 05 - 10 2018 vitit god year			
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot. Br.Prot: Prot.No:	Sëtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	5801/2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr.547/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi dhe Gjylinaze Gola- anëtar, Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A. Nr.547/2018, të datës 27.08.2018 së ankuesit Bexhet Bregaj, me adresë banimi fsh Staniovc i Epërm'', nga Komuna e Vushtrrisë, për mes përfaqësuesit juridik Avokatit Skender Musa kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrrisë , në çështjen juridike " ndërprerjeje e marrëdhënies së Punës', duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.10.2018, mori këtë

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A. Nr. 547/2018, të datës 27.07.2018 të parashtruar nga ankuesi Bexhet Bregaj.

.

A r s y e t i m

Ankuesit Bexhet Bregaj, i punësuar në pozitën „Drejtor i SHFMU „Migjeni'', në Fshatin Stanovc i Epërm, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Vushtrrisë me datë 21.05.2018, ka nxjerr vendim me të cilin e ka sistemuar në pozitën e mësimdhënës i Biologjisë, në SHFMU „ Nazmi Zhegrova''.

Ankuesi Bexhet Bregaj, i pakënaqur me vendimin e datës 21.05.2018, të nxjerr nga Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, me datën 18.06.2018, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave tek Komuna e Vushtrrisë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Komunës së Vushtrrisë, me datë 17.07.2018, me numër protokolli 34823/18, ka nxjerr vendim me të cilën e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi Bexhet Bregaj, i pakënaqur me vendimin me nr. protokolli 34823/18, të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Vushtrrisë, përmes postës me datë 20.08.2018, ka parashtruar ankesë e cila ankesë është pranuar me datë 27.08.2017 me numër protokolli 4922//2018, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se procedurat e Ndërprerjeje se marrëdhënies se punës Drejtor i SHFMU „Migjeni'', në Fshatin Stanovc i Epërme, është bërë në kundërshtim me Ligjin për Shërbimin Civil dhe aktet nënligjore në fuqi, nga Komuna e Vushtrrisë .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.08.2018, me numër protokolli 4967/2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Komuna e Vushtrrisë, ndërsa me datën 14.09.2018 me numër protokolli 5318/2018, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Vushtrrisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 547/2018, e datës 27.08.2018, me numër protokolli 4922/2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 17.07.2018, me numër protokolli 34823/18, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Vendimi i datës 21.05.2018; Ankesa e datës 18.06.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Autorizimi i datës 02.07.2018;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Bexhet Bregaj. **është e palejuar,** ***sepse:***

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi Vendimin me Nr. 34823/18 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Vushtrrisë, e ka pranuar me datën 19.07.2018, ndërsa ankesën e ka parashtruar me datën 20.08.2018, për mes postës së Kosovës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e që është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e anekseve.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ankuesi kundër Vendimin me 34823/18 të datës 17.07.2018 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Vushtrrisë, më datë 20.08.2018 ka parashtruar ankesë për mes juridik Avokatit Skender Musa, për mes postes së Kosovës, e cila ankese është pranuar me datën 27.08.2017,me numër protokolli 4922/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prej momentit kur e ka pranuar Vendimin 34823/18 të datës 17.07.2018, të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Vushtrrisë, e që është jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: ***Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"***, nenit 11 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, i cili përcakton se: ***"Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, brenda afatit prej 30 ditësh".*** Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se nga shkresat e lendes del se ankuesi ankesën kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave e ka pranuar me datën 19.07.2017, ndërsa ankesën e ka dorëzuar për mes juridik Avokatit Skender Musa, me datën 20.08.2018, për mes postes se Kosovës, e që eshte jashtë afatit Ligjor.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 547/2018, me datë 03.10.2018

Eshref *SHABANI*
Kryetar i Kolegjit

Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit; Bexhet Bregaj;*
- *Përfaqësuesit Juridik avokatit Skender Musa;*
- *Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vushtrrisë;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*